



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0826**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Kimete Gashi Kryetare, Batisha Ibrahim Anëtare dhe Vedat Poterqoi Anëtar duke vendosur sipas ankesës së (OE) “EL-BAU” SH.P.K., kundër vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “Komuna e Prishtinës” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Intervenime Infrastrukturore -ndarja zonale në 6 zona, në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” LOT 6 me numër të prokurimit 616-24-3595-5-1-1, me 08/11/2024, mori:

## Vendim

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** ankesa e OE “El Bau” Sh.P.K. me nr. 2024/0826 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “84 Renovime dhe mirembajtje e Institucioneve vartese dhe hapësirave kulturore” me numër të prokurimit Intervenime infrastrukturore – ndarja zonale në 6 zona, në tërë territorin e Komunës së Prishtinës (lot 6)” me numër të prokurimit 616-24-3595-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - Komuna e Prishtinës.
- 2. Mbetet në fuqi** Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues i datës 20.08.2024ë afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarrë lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
- 3. Meqenëse** ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## Arsyetim

*-- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me datë 27.05.2024 Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “84 Renovime dhe mirembajtje e Institucioneve vartese dhe hapësirave kulturore” me numër të prokurimit Intervenime infrastrukturore – ndarja zonale në 6 zona, në tërë territorin e Komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-24-3595-5-1-1. Autoriteti Kontraktues gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës për punë, me vlerë të parashikuar për lot 6 është 1,400,000.00€.

Me datë 20.08.2024, AK ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 ku për lot 6 të këtij aktivitetit të prokurimit ka shpërblyer me kontratë GOE “Eskavatori ShPK & Beni Construction ShPK”.

Me datë 26.06.2024, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin B58, të cilën AK e ka refuzuar si të pabazuar me datë 29.08.2024.

Me datë 09.09.2024 operatori ekonomik ankues ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2024/0826.

*- Mbi fazën e shqyrtimit paraprak -*

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

***Pretendimet e operatorit ekonomik ankues*** janë se tenderuesi i rekomanduar për kontratë për lot 6 “Company Eskavatori shpk & Beni Construction shpk” ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme pasi që anëtari i GOE nuk ka dorëzuar dëshmitë dokumentare lidhur me certifikatën ISO 9001 2015. Tutje OE ankues ka pretenduar se tenderuesi i rekomanduar për pajisjen mjet ngritës me pirun ka dorëzuar vetëm DUD doganor por jo edhe librezën e qarkullimit. OE ankues po ashtu ka pretenduar se edhe disa nga tenderuesit tjerë për këtë lot të cilët janë shpallur si të pasuksesshëm është dashur që të eliminohen nga aktiviteti i prokurimit si tenderues të papërgjegjshëm.

***- Vlerësimi dhe administrimi i provave -***

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 16.09.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës ndërsa me datë 26.09.2024 është dorëzuar raporti i ekspertizës nga eksperti shqyrtues me rekomandimet si në vijim: “*Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe*

*rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.*

### **Konstatimet e ekspertit shqyrtues**

*Ekspertja shqyrtuese lidhur me ISO standardin si kërkesë e sigurimit të cilësisë e përmendur në nenin 70 të LPP-së, gjithashtu e përmendur si kërkesë e cila duhet të përmbushet nga secili anëtar i grupit të konzorciumit në nenin 26 të Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, paragrafi 6, dhe poashtu në Komisionin rregullativ të prokurimit publik tek interpretimet gjendet pyetja me nr. 29 e datës 22.06.2023, e cila e specifikon ISO standardin si pjesë e nenit 70 të LPP-së, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar, dhe sipas sqarimeve më larte rekomandohet që lënda të kthehet në rivlerësim.*

*Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, bazuar në e-prokurim, në ofertën e OE në fjalë në listë gjenden disa “mjete ngritës ngarkues” me marrëveshje dhe DUD, e cila sipas sqarimit edhe më lartë tek pretendimet ankimore të GOE të rekomanduara, AK duhet ta sqaroj të njëjtën lidhur me marrjen pjesë në trafik rrugor. Andaj pretendimi OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.*

*Ekspertja shqyrtuese tutje sqaron se, OE ankues në ankesë ka bashkangjitur pretendime ankimore për të gjithë ofertuesit për LOT 6, duke cekur po ashtu edhe emrat e operatorëve ekonomik të rekomanduara nëpër lote të tjera, të cilët sipas AK-së mund të rekomandohen vetëm për një LOT, gjithashtu operatorët ekonomik ofertues: GOE “Bini SHPK & TMG Group SHPK, GOE BENI-COM SHPK & All stone SHPK & Saba Belca SHPK, dhe GOE ABC SHPK, janë të eliminuar nga AK po ashtu.*

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përdërisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

### **- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -**

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këtë lëndë janë pjesërisht të qëndrueshme. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin vetëm pjesërisht konstatimeve të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit,

vlerësimit dhe krahasimit të ofertave ka vepruar në përputhje me LPP në fuqi.

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe operatorit ekonomik fitues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet tjera relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Sa i përket pikës së pretendimit ankimor të OE ankues kundër tenderuesit të rekomanduar, duhet cekur se çertifikata ISO 9001 2015 është përcaktuar si kërkesë teknike dhe profesionale në kuptim të nenit 69 të LPP dhe nuk është kërkuar si kërkesë e përshtatshmërisë. Përmes nenit 71 par. 4 të LPP përcaktohet se *“Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit”*. Në anën tjetër as për OE ankues dhe as për ekspertin shqyrtues nuk është kontestues faktin që tenderuesi i rekomanduar si grup i operatorëve ekonomik e ka dorëzuar dokumentin e tillë pasi që dilemat e parashtruesit ndërliidhen vetëm me njërin anëtar të grupit. Paneli Shqyrtues në këtë rast i referohet edhe interpretimit të KRPP nr. 29 të datës 22.06.2023, i cili në paragrafin e fundit specifikon, citat: *“Në përputhje me nenin 71 të LPP-së, si dhe nenin 26.10 të Rregullores për Prokurimin Publik, AK në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, do t'i specifikojë qartë kërkesat që duhet t'i përmbushin anëtarët e grupit (konzorciumit) duke përcaktuar qartë dëshmitë që duhet të sillen nga secili anëtar i grupit së bashku me tenderin e tyre”*, Kështu që, duke u nisur nga ky interpretim sqaron se në rastet kur në dosjen e tenderit AK nuk përcakton specifikisht çertifikatat ISO të ofrohen nga të gjithë anëtarët e GOE apo vetëm nga njëri anëtar, atëherë kërkesa e DT nuk mund të interpretohet në disfavor të asnjërit nga tenderuesit si GOE. Në këtë drejtim vlen të shtohet edhe fakti se me rregulloren e vjetër RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK e vitit 2021, por edhe rregulloret tjera paraprake, dispozita 26.6 nuk ka ekzistuar fare dhe atehere kanë mundur që këtë kërkesë ta plotësojnë secili anëtar i grupit, po ashtu edhe përmes rregullores së re të prokurimit publik A001 dhe A002 e vitit 2024 është larguar në tërësi neni 26.6 i RRPP të vjetër dhe sipas nenit 26.8 të RRPP të re, mjafton që çertifikatat ISO të dëshmojnë vetëm nga njëri prej anëtarëve të GOE. Duke u nisur nga keto fakte dhe me eliminimin e kesaj dispozite nga ana e KRPP-se , Paneli konsideron se kjo dispozite nenligjore nuk ka pasur mbeshtetje ne Ligjin e Prokurimit Publik aktual. Andaj, duke u nisur nga këto fakte dhe veprime, si dhe duke u nisur edhe nga kërkesat e DT dhe NJK, rrjedhimisht nga çdo këndvështrim pretendimi ankimor është gjetur si i pabazuar.

Lidhur me pretendimet ankimore drejtuar kundër tenderuesve të shpallur si të pasuksesshëm në këtë aktivitet të prokurimit lot 6, Paneli Shqyrtues ka gjetur se asnjë nga këto pretendime nuk janë relevante për të ndryshuar epilogun përfundimtar të këtij vendimi për shkak të të gjeturave lidhur me pretendimet ankimore të drejtuara kundër tenderuesit të rekomanduar.

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me mjetin ngritës me pirun, Paneli Shqyrtues pajtohet me konstatimin e ekspertit shqyrtues se ky pretendim është pjesërisht i bazuar. Kjo për arsye se në njërin anë nuk është kontestues fakti që tenderuesi i rekomanduar e ka dorëzuar DUD doganor për këtë pajisje duke dëshmuar pronësinë/posedimin e kësaj pajisje sikurse ka qenë edhe kërkesa e dosjes së tenderit. Megjithatë në anën tjetër AK nuk ka sqaruar nëse destinimi i këtij mjeti sipas paramasës dhe projektit është për qarkullim në trafik apo për tjera funksione në vendpunishte, mbi të cilën bazë tenderuesi i rekomanduar duhet që përpos DUD doganor të dëshmojë ose jo edhe librezën e qakullimit. Sidoqoftë duhet të theksohet se autoriteti kontraktues e gëzon

autonominë e plotë për të ekzaminuar, krahasuar edhe vlerësuar të gjitha ofertat e pranuar në një aktivitet të prokurimit. Në rastin konkret AK ka vlerësuar dokumentet në mënyrën e elaboruar si më sipër, nuk ekziston bazë e mjaftueshme për të kthyer në rivlerësim aktivitetin e prokurimit vetëm sa i përket këtij fakti. Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e buxhetit publik të AK.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të miratohet pjesërisht e bazuar ndërsa Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Komuna e Prishtinës i datës 20.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull *“84 Renovime dhe mirembajtje e Institucioneve vartese dhe hapësirave kulturore”* me numër të prokurimit Intervenime infrastrukurore – ndarja zonale në 6 zona, në tërë territorin e Komunës së Prishtinës (lot 6)” me numër të prokurimit 616-24-3595-5-1-1 duhet të mbetet në fuqi, pasi që nuk ekzistojnë argumente të mjaftueshme ligjore për të urdhëruar AK që të kthej aktivitetin e prokurimit në rivlerësim, për arsytet e elaboruara si më sipër në këtë vendim.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues gjatë krahasimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit, ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se *“Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”*. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut në aspektin e parandalimit të vonesave të paarsyeshme në këtë aktivitet të prokurimit. Paneli Shqyrtues njëkohësisht ka marrë parasysh edhe faktin se dallimi në çmim është rreth 400,000.00 euro më i lirë.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacionin tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veprojë në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të iniciojë procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Kimete Gashi**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - EL-BAU SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: